



---

**UNIVERSITETI I TETOVËS**  
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

**UNIVERSITETI I TETOVËS**

**RAPORT I VETEUVALUIMIT TË UNIVERSITETIT TETOVËS**  
**(PËR PERIUDHËN 2016/17-18/19)**

**TETOVË, DHJETOR 2021**



**UNIVERSITETI I TETOVËS**  
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

## Përmbajtja

Hyrje .....	3
2. Konsteksti institucional.....	4
2.4. Situata rajonale dhe nacionale e tregut të punës .....	4
2.5. Struktura e studentëve dhe kuadrit akademik.....	5
3. Normat, vlerat, Misioni dhe qëllimi i universitetit .....	7
4. Qeverisja dhe aktivitetet .....	8
4.1. Qeverisja institucionale dhe vendimmarrja .....	8
4.2. Mësimdhënia dhe mësimnxënia .....	9
4.3. Kultura e kualitetit .....	10
4.4. Aktivitetet kërkimore.....	11
4.5. Anketimi i studentëve.....	12
5. Evaluim i aktiviteteve të Universitetit .....	13
6. SWOT analiza .....	15
7. Përfundim .....	16
8. Shtojca .....	17



## Hyrje

Vetevaluimi i Universitetit të Tetovës paraqet një vazhdimësi të procesit të evaluimit të periudhës 2013-2016, në bazë të së cilit u realizua edhe evaluimi i jashtëm nga expert ndërkombëtarë të AUE (Asocijacionit të Universiteteve Evropiane) gjatë periudhës Prill Tetorë 2017.

Universiteti i Tetovës duke ndjekur strategjitë e programeve institucionale për evaluim, fuqishëm është orientuar drejt përforsimit të kapaciteteve të tij dhe me qëllim të sigurojë vazhdimësi në zhvillimin dhe rritjen e kualitetit në të gjitha sferat e veprimit të Universitetit, Senati i Universitetit më 12.12.2019, zgjodhi anëtarët e Komisionit për evaluim, me mandat katërvjeçar. Komisioni është në përbërje nga 11 anëtarë, nëntë prej të cilëve janë mësues të ndryshme të ndryshme si dhe tre student të propozuar nga parlamentet studentor.

Komisioni u obligua që të realizojë procesin e evaluimit dhe të përpilojë raportin e vetevaluimit për periudhën 2016/17, 2017/18, dhe 2018/19, në të cilin dotë merren parasysh udhëzimet për vetevaluim të Bordit për akreditim dhe evaluim të R. Së Maqedonisë së Veriut, kahjet për evaluim institucional të AUE-së si dhe rekomandimet e ekspertëve të cilët realizuan evaluim të jashtëm.

Planifikimi i realizimit të vetevaluimit gjatë pranverës së vitit 2020 u pamundësua për arsye të ndryshimit të rrethanave të zbatimit të vëprimit në të gjitha sferat e Universitetit si pasojë e pandemisë nga Covid 19. Pas fillimit të “normalizimit” të veprimit të aktiviteteve në Universitet, procesi i vetevaluimit për periudhën trevjeçare 2016-2019 përfundoi gjatë vitit 2021.

Aspektet specifike të evaluimit të institucionit në tërësi janë: Vlerësimi i kualitetit të programeve studimore si dhe raporti i tyre me tregun e punës, Vlerësimi i kualitetit të stafit akademik si dhe vlerësimi i kualitetit të aktiviteteve hulumtuese. Pavarësisht se anketimi i studentëve nuk ka qenë qëllim i vetevaluimit, në raport janë paraqitur edhe të dhëna të përgjithshme nga anketimi me student.

Procesi i evaluimit është realizuar në bashkëpunim të drejtëpërdrejtë me komisionet për vetevaluim të njësive akademike të Universitetit. Anëtarët e komisionit qëndorë për evaluim organizimin e procesit e realizuan duke ndarë detyrat sipas kompetencave përkatëse të gjithsecilit. Mbështetja logjistike për realizim të vetevaluimit ishte nga Zyra për menaxhim me cilësi dhe evaluim. Ky raport është krijuar duke u mbështetur në të dhënat e ofruara nga raportet e vetevaluimit të njësive akademike të Universitetit të Tetovës të cilat pas hartimit të raporteve si dhe miratimit të të njëjtave në këshillat



mësimor-shkencor të njësive akademike, raportet iu adresuan kryetarit të komisionit qendror për evaluim. Në nëtor të vitit 2020 njësitë u njoftuan në lidhje me fillimin e procesit të evaluimit.

Vështirësitë me të cilat u ndesh Komisioni qendror kishin të bëjnë me sasinë e madhe të të dhënave dhe llojllojshmërinë e raporteve të njësive akademike.

## 2. Konsteksti institucional

Pika 2.1. që ka të bëjë me zhvillim historik të intucionit, pika 2.2. ku përshkruhet pozita gjeografike e Universitetit si dhe 2.3. ku paraqitet autonomia e Universitetit janë të njëjta me përmbajtjen e titujve me të njëjtin emërtim të paraqitura në raportin për vetevaluim të vitit 2013-2016.

### 2.4. Situata rajonale dhe nacionale e tregut të punës

Sipas Entit shtetëror të Statistikës, në periudhën para fillimit të pandemisë, respektivisht në tremujorin e katërt të vitit 2019, shkalla e punësimit është 47,9 %, kurse në periudhën e njëjtë të vitit 2020 shënohet një ulje prej 46, 8%. Në periudhën e njëjtë, shkalla e papunësisë, në periudhën para pandemisë, gjegjësisht në tremujorin e katërt të vitit 2019 është 16,6%, kurse në tremujorin e njëjtë të vitit 2020 është 16,1 %, respektivisht vërehet një tendencë uljeje prej 1000 persona.

Nga ana tjetër, popullata aktive, në tremujorin e katërt të vitit 2019 është 57.5 kurse në periudhën e njëjtë të vitit 2020 është 55.9, gjegjësisht vërehet një tendencë e uljes prej 1.6. Nga këto të dhëna mund të konstatohet që zvogëlimi i numrit i të papunëve nuk është rezultati i punësimit të tyre, por paraqitet si rezultat i zvogëlimit të numrit të popullates aktive. Kjo rrjedh nga fakti që një numër i caktuar i të punësuarëve dhe i të papunëve nuk janë pjesë e fuqisë punëtore. Faktorë të ndryshëm mund të kontribuojnë që individët nuk punojnë apo nuk kërkojnë punë në tregun e punës dhe kjo të rezultojë në uljen e shkallës së punësimit dhe të papunësisë.

Sipas analizës së McKinsey Global Institute por bazuar edhe në hulumtime tjera të shumta, vërehet që profesionet në fusha të ndryshme nga STEM (science, technology, engineering, and mathematics) bëjnë pjesë në grupin e profesioneve me rangim më të lartë të profesioneve në botë. Ngjarjet nga viti fillimi i vitit 2020 në veçanti pandemia me covid 19 ka ndikuar në masë të madhe në transformimin digjital të shoqërisë në tërësi. Automatizimi dhe digjitalizimi në kohën e pandemisë, me qëllim që



## UNIVERSITETI I TETOVËS УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

puna të kryhet në formë të sigurt dhe efektive paraqiten si një hap i domosdoshëm në periudhën aktuale por edhe në periudhën e ardhshme. Sipas projeksioneve të Forumit Botëror Ekonomik, si profesione më të kërkuara do të jenë: Data analistët dhe shkenctarët, Specialistët për inteligjencë artificiale dhe mësim maqinerik, Specialistë për të dhëna të mëdha (Big data), Specialistë për marketing digjital dhe strategji dhe Specialistë për automatizim të proceseve. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut shënohet një përpjekje e vazhdueshme për ndjekjen e trendeve globale në profilizimin e profesioneve në të ardhmen, edhe pse një projektim i tillë bazuar kryesisht në lëvizjet globale do të ishte pjesërisht efektive, duke marrë parasysh rrethanat e kufizuara dhe kushtet e funksionimit të ekonomisë në tërësi në vend. Prandaj në kuadër të sistemeve egzistuese arsimore bëhet një përpjekje e vazhdueshme për aftësimin e studentëve dhe shkathtësimin e tyre për një përshtatje më të lehtë dhe më të suksesshme në tregun e punës. Zhvillimet teknologjike gjithashtu shënojnë një rritje të shpejtë, prandaj edhe detyrë tjetër e rëndësishme e sistemit arsimor, krahas përpjekjeve të lartëpërmendura, është që të jenë të aftë në parashikimin e këtyre ndryshimeve, me qëllim të zvogëlimit të diskrepancës në mes të ofertës dhe kërkesës në tregun e punës por edhe për përshtatje me rrethin global ekonomik por edhe me rrethin e përgjithshëm. Sipas anketës për nevojat e shkathtësive në tregun e punës në RMV, për vitin 2018/2019, si profesione më të kërkuara me arsim të lartë, sipas Klasifikimit Nacional të Profesioneve janë Programuesit dhe Inxhinierë maqinerik. Duke u bazuar nga të dhënat e Employe Servis International, me qëllim të analizës së kërkesës për kuadro me arsim të lartë dhe kërkesë për kualifikimet e nevojshme, si profesione më të kërkuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut mund të rradhiten: Programues, Inxhinierë maqinerik, Inxhinierë ndërtimi, ekonomistë, Mjekë të përgjithshëm, Inxhinierë të informatikë, Inxhinierë për organizim të punës, Ekonomistë për sistemin banker, Arqitektë, Inxhinierë për shkencat kompjuterike, Kontabilitë, Inxhinierë për siguri teknike, Inxhinierë-metalurg për përpunim të metalit, Jursite, Elektroinxhinierë-kontrollorë, Menaxherë të prodhimit dhe shitjes, Inxhinierë-agronom, Farmaceut-teknologj, Agjent marketing, Dizajner grafiku, Administrue të bazës së të dhënave dhe të ngjashme.

### 2.5. Struktura e studentëve dhe kuadrit akademik

Numri i përgjithshëm i studentëve në nivel Universiteti gjatë viteve akademike 2016-2019 është në rënie të vazhdueshme në të gjitha njësitë akademike. Më konkretisht nëse ndjekim të dhënat tabelare (Shtojca 1) vërrehet tendencë e zvogëlimit të studentëve të regjistruar në njësitë e fakultetit Pedagogjik. Nga këto të dhëna mund të shihet që në vitet akademike 2016/2017, 2017/2018 dhe 2018/2019 në Fakultetin Pedagogjik shënohet një tendencë e uljes së numrit të studentëve, respektivisht në vitin akademik 2017/2018 shënohet ulje prej 80 studentë në krahasim me vitin paraprak akademik kurse në vitin akademik 2018/2019 shënohet ulje minimale prej 10 studentë në



krahasim me vitin paraprak akademik. Në Fakultetin Filozofik poashtu shënohet një ulje e numrit të studentëve, respektivisht në vitin akademik 2017/2018 numri i studentëve është 632 që nënkupton ulje të numrit të tyre prej 56 studentë në krahasim me vitin paraprak akademik kurse në vitin akademik 2018/2019 numri i studentëve është 527 që nënkupton një ulje prej 105 studentë në krahasim me vitin paraprak akademik. Në Fakultetin Ekonomik në vitin akademik 2016/2017 numri i përgjithshëm i studentëve është 228. Nga këto të dhëna mund të shihet që në vitet akademike 2016/2017, 2017/2018 dhe 2018/2019 në Fakultetin Ekonomik shënohet një ulje e numrit të studentëve, respektivisht në vitin akademik 2017/2018 shënohet ulje prej 67 studentë në krahasim me vitin paraprak akademik kurse në vitin akademik 2018/2019 shënohet ulje minimale prej 25 studentë në krahasim me vitin paraprak akademik. Trendi i rënies në numrit të studentëve vërrehet edhe në njësitë akademike tjera si Fakultetin Juridik shënohet një ulje e numrit të studentëve, respektivisht në vitin akademik 2017/2018 shënohet ulje prej 52 studentë në krahasim me vitin paraprak akademik kurse në vitin akademik 2018/2019 shënohet ulje minimale prej 37 studentë në krahasim me vitin paraprak akademik. Nga këto të dhëna mund të shihet që në vitet akademike 2016/2017, 2017/2018 dhe 2018/2019 në FSHMN shënohet ulje e numrit të studentëve, respektivisht në vitin akademik 2017/2018 shënohet ulje prej 28 studentë në krahasim me vitin paraprak akademik kurse në vitin akademik 2018/2019 shënohet ulje minimale prej 4 studentë në krahasim me vitin paraprak akademik. Në fakultetin e Shkencave të zbatuara që në vitin akademik 2017/2018 shënohet ulje për 56 studentë, kurse në vitin vijues akademik 2018/2019 shënohet rritje e numrit të studentëve për 36 në krahasim me vitin paraprak akademik.

Kuadri mësimor shkencor i Unviersitetit në vitin akademik 2016/17 është 234 kurse e bashkëpunëtorëve 59 (Shtojca 2). Gjat vitit akademik 2018/19 ky numër arrinë në 249 mësimdhënës, si dhe në 62 bashkëpunëtorë (asistent). Me qëllim të arritjes së realizimit efikas të procesit mësimor shkencor në Unviersitet, 127 mësimdhënës janë të angazhuar me kontratë në vepër. Për ilustrim, p.sh. në fakultetin Filologjik në vitin akademik 2016/2017 në procesin e mësimdhënies janë angazhuar gjithsej 29 profesorë me status të rregullt, edhe atë: 4 profesorë ordinarë, 5 profesorë inordinarë dhe 20 docentë. Struktura gjinore e profesorëve është 55% meshkuj dhe 45% femra. Me qëllim të realizimit të suksesshëm të procesit mësimor në këtë vit akademik, Fakulteti Filologjik ka angazhuar staf akademik me kontratë me gjithsej 17 mësimdhënës, prej tyre 11 profesorë ordinarë, 1 inordinarë dhe 5 docentë. Struktura gjinore e mësimdhënësve të angazhuar është e përbërë prej 59% meshkuj dhe 41% femra. Nëse krahasohen të dhënat e paraqitura në mes të tri viteve akademike, mund të vërehet që numri i profesorëve në marrëdhënie të rregullt pune në vitin akademik 2018/19 në



krahasim me vitet paraprake shënon rritje për 5 profesorë, kurse te profesorët me kontratë në vepër shënohet ulje e numrit të tyre për 4 në krahasim me vitet paraprake akademike.

Në Fakultetin Juridik në vitin akademik 2016/2017 në procesin e mësimdhënies janë angazhuar gjithsej 28 profesorë me status të rregullt, edhe atë: 5 profesorë ordinarë, 3 profesorë inordinarë dhe 20 docentë. Struktura gjinore e profesorëve është 82% meshkuj dhe 18% femra. Me qëllim të realizimit të suksesshëm të procesit mësimor në këtë vit akademik, Fakulteti Juridik ka angazhuar staf akademik me kontratë me gjithsej 9 mësimdhënës, prej tyre 1 inordinar dhe 8 docentë. Në vitin akademik 2018/19 në krahasim me vitet paraprake shënon ulje të numrit të punësuarëve për 3 profesorë, kurse tek të punësuarit me kontratë shënohet një lëvizje e ndryshueshme, respektivisht në vitin akademik 2016/2017 kemi rritje të numrit të të punësuarëve për 8 profesorë kurse në vitin akademik 2018/2019 shënohet ulje për 10 profesorë në krahasim me vitin paraprak akademik. Numri i mësimdhënësve të rregullt si rezultat i pensionimit pëson rënie, kurse angazhimi i ndryshueshëm për vite i stafit akademik përveç procesit natyror të pensionimit varet edhe nga numri i studentëve të regjistruar përgjatë viteve të caktuara akademike.

Nëse vëzhgohet numri i kuadrit akademik në fakultetin e shkencave matematike natyrore mund të vërehet që numri i profesorëve në marrëdhënie të rregullt pune gjatë tre viteve akademike është relativisht i njëjtë i pasuar me ndryshime minimale, kurse tek të punësuarit me kontratë shënohet ulje e numrit të të punësuarëve, respektivisht në vitin akademik 2017/2018 shënohet një ulje për 6 profesorë, kurse në vitin vijues akademik 2018/2019 shënohet rritje për një profesor.

Zgjedhja e kuadrit akademik realizohet nëpërmjet konkurseve publike në pajtueshmëri me kriteriumet e shënuara në Ligjin për arsim të lartë dhe rregullores së Unviersitetit për zgjidhje në thirrje.

### 3. Normat, vlerat, Misioni dhe qëllimi i universitetit

Për periudhën e viteve akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19 nëntemat që vijojnë 3.1. Vizioni, misioni dhe qëllimet strategjike të Universitetit; 3.2. Qeverisja dhe menaxhimi; 3.3. Profili i universitetit; 3.4. Pozita e Universitetit në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar janë të njëjta me elaborimin e nëntemave të njëjta nga Raporti për vetëevaluim të vitit 2017\*(Ndryshimet e ligjit për arsim të lartë (Gazeta Zyrtare e R.M, nr. 82, 8.5.2018) që kanë të bëjnë me qeverisjen dhe menaxhimin, vijojnë të jenë të njëjta deri në përfundim të mandatit të Senatit të Universitetit.



## 4. Qeverisja dhe aktivitetet

### 4.1. Qeverisja institucionale dhe vendimmarrja

UT paraqet universitet të integruar, organizimi dhe veprimtaria e të cilit bazohet në autonominë institucionale. Organet vendimmarrëse janë të strukturuar në 3 nivele: në nivel universitar, në nivel të njësive akademike dhe programeve studimore.

Organet e universitetit janë: Senati i Universitetit, Këshilli i Rektoratit dhe Rektori. Senatin e përbëjnë nga dy përfaqësues të fakulteteve si dhe tre përfaqësues të studentëve. Përfaqësuesit e fakulteteve zgjidhen nga Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit me votim të fshehtë, kurse studentët nga Parlamenti Studentor. Rektori dhe prorektorët janë antërarë të Senatit sipas funksionit \* (Ndryshimet e ligjit për arsim të lartë (Gazeta Zyrtare e R.M, nr. 82, 8.5.2018) që kanë të bëjnë me qeverisjen dhe menaxhimin, vijojnë të jenë të njëjta deri në përfundim të mandatit me përbërjen momentale të Senatit të Universitetit).

*Senati* është organi që siguron autonominë e Universitetit, sjell vendime, rregullore, udhëzime dhe përfundim. Senati është kompetent për të sjellë Statutin e Universitetit dhe rregulloret e punës. Ai vendos për politikën akademike, aktivitetet akademike, çështjet financiare, bën zgjedhjen e stafit akademik, publikime etj.

*Rektori* është organi që e udhëheq dhe e prezanton Universitetin në vend dhe jashtë. Disa nga kompetencat më të rëndësishme të Rekorit janë si vijojnë: realizon vendimet dhe përfundimet e Senatit; sentatit dhe këshillit të rektoratit ju drejton propozime dhe akte tjera të përgjithshme shqyrtimi dhe zgjidhjet e të cilave janë nën kompetencat e Senatit të Unviersiteti; udhëheq me bashkëpunimin ndërkombëtar dhe inicion bashkëpunim me unviersite tjera të vendit dhe të huaja; dorëzon raport për punën e Unviersitetit deri te Senati dhe themeluesi i unviersitetit etj.

*Këshillin e Rektoratit* e përbëjnë: Rektori, prorektorët, dekanët, përkatësisht drejtorët e njësive të Universitetit dhe përfaqësues të Parlamentit Studentor të Universitetit. Disa nga kompetencat e Këshillit të Rektoratit janë: të përgatit dhe të propozojë aktet dhe çështjet materiale, për të cilat vendos Senati, për aktivitetet akademike, shpall konkurs për regjistrimin e studentëve të ciklit të parë të dytë dhe të tretë, me pëlqimin paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, jep mendim për programet studimore në njësitë e Universitetit, sjell vendime për bashkëpunimin aktual ndërkombëtar.





*Organizimi i njësive* akademike rregullohet me rregullore që është e unifikuar për të gjitha njësitë akademike të Unviersitetit. Organet e fakultetit janë: Këshilli mësimor-shkencor, dekani dhe këshilli i dekanatit. Organi më i lartë i cili sjellë vendime në kuadër të njësisë akademike është Këshilli mësimor-shkencor, të cilin e përbëjnë profesorët ordinarë, inordinarë, docentët, si dhe studentët, të cilët i zgjedh Parlamenti Studentor. Kompetencat e këshillit mësimor-shkencor të fakultetit janë sjellja e rregullores, programit katër vjeçar për zhvillim dhe programit vjetor për punë; propozon numër të studentëve për regjistrim në vit të parë për të tre ciklet studimore. Gjithashtu i zgjedh anëtarët e Komisionit për Evaluim të brendshëm dhe sjell udhëzim për evaluimin e njësive.

#### 4.2. Mësimdhënia dhe mësimnxënia

Universiteti i Tetovës ofron mundësi për studime të kontinuuara në tre cikle studimore dhe atë ciklin e parë të studimeve, ciklin e dytë të studimeve si dhe studime të doktoraturës. Të gjitha programet studimore në kuadër të trembëdhjetë njësive akademike janë të dizajnuara sipas sitemit të Bolonjës dhe kredit transfer sitemit evropian (ECTS) si dhe regulativës nacionale. Programet studimore akreditohen nga Agjencioni për akreditim dhe evaluim të arsimit të lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Programet studimore të ciklit të parë, përmbajnë 180 deri 240 kredi dhe zgjasin tre deri katër vite. Programe studimore të caktuara, të cilat janë në lidhshmëri me realizimin e profesioneve të rregullta realizohen të integruara në ciklin e parë dhe të dytë: Studimet bazike në fushën e mjekësisë përfshijnë gjashtë vite studime teorike dhe trajnimi praktik, i cili realizohet në Universitet; studimet bazike të fushës së farmacisë dhe stomatologjisë përfshijnë 5 vite të studimit në formë të rregullt.

Varësisht nga lloji i programit ato vlerësohen si profesionale ose si programe studimore akademike. Programet studimore të ciklit të dytë përmbajnë 60 ose 120 kredi varësisht nga kohëzgjatja e ciklit të parë të studimeve, që në total cikli i parë dhe i dytë i studimeve të kapin vlerën e 300 kredive. Programet studimore të ciklit të tretë përmbajnë 180 kredi. Këto studime zgjasin tre vite dhe vlerësohen si studime doktorale.

Në të gjitha programet studimore (në të gjitha vitet e studimeve) lëndët e obligueshme janë të fushës përkatëse të njësisë akademike, respektivisht të njësisë organizative të brendshme dhe numri i tyre përfshin deri në 60% të numrit të përgjithshëm të lëndëve. Pjesën tjetër e përbëjnë lëndët zgjedhore, rreth 30% prej tyre janë lëndë të cilat i zgjedhin studentët nga lëndët e njësisë akademike të universitetit si dhe 10% lëndë zgjedhore të cilat studentët i zgjedhin nga lista e lëndëve të lira zgjedhore të propozuara nga çdo njësi e Universitetit. Universiteti është i orientuar drejt



ndërkombëtarizimit e në këtë drejtim ofron studime edhe në gjuhën angleze. Në dy programe studimore, në ciklin e parë të studimeve si dhe në katër drejtime të ciklit të dytë ofrohet ndjekja e mësimi dhe testimi në gjuhën angleze. Në ciklin e parë, programi studimor i Shkencave politike dhe Informatikës ofrojnë studime në gjuhë angleze kurse në ciklin e dytë, në dy drejtime, në kuadër të programit studimor Studime politike: Marrëdhëne ndërkombëtare dhe Studime Evropiane si dhe në programet studimore: Fizikë dhe Informatikë në kuadër të Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore.

#### 4.3. Kultura e kualitetit

Universiteti i Tetovës në vazhdimësi kujdeset për sigurim dhe avansim të kualitetit të të gjitha sferave të saja vepruese nëpërmjet mekanizmave për sigurim të cilësisë edhe atë si për pjesën akademike por edhe për pjesën administrative dhe teknike. Në bazë të ligjit për arsim të lartë ( Gayeta zyrtare) sistemi i sigurimit, vlerësimit, zhvillimit dhe avansimit të kualitetit në arsim të lartë përfshinë: miratim, vërtetim dhe pranim të institucionit të arsimit të lartë dhe programeve studimore për realizim të veprimtarisë në arsim të lartë që realizohet nëpërmjet akreditimit; vlerësimi i kualitetit të veprimtarisë në arsimin e lartë, menaxhimi, finansimi, aktivitetet akademike dhe prioritetet e saj realizohen nëpërmjet sistemit të evaluimit; sistemi i sigurimit, vlerësimit, zhvillimit dhe avansimit të arsimit të lartë realizohet nëpërmjet Këshillit nacional për arsim të lartë dhe veprimtarisë kërkimore-hulumtuese si dhe Agjencionit për kualitet të arsimit të lartë.

Spas Ligjit për arsim të lartë dhe statutit të unviersitetit, vetëevaluimi, vlerësimi i kualitetit të mësimdhënësve si dhe evaluimi I jashtëm paraqesin detyrim nëpërmjet të cilit sigurohet cilësia në arsimin e lartë në Republikë.

Evaluimi I jashtëm realizohet nga Bordi për evaluim në kuadër të Agjencionit për kulaitet të arsimit të lartë çdo pesë vjet. Bordi për evaluim vlerëson universitetet npërmjet ndjekjes dhe vlerësimit të kualitetit gjatë realizimit të veprimtarisë në arsim të lartë, veprimtarisë kërkimore-shkencore, punës profesionale dhe artistike të stafit akademik dhe në veçanti programeve studimore. Standardet dhe procedurat sipas së cilave realizohet evaluimi I jashtëm janë të përfshira në Rregulloren për standarde dhe procedurë për evaluim të jashtëm dhe vetevaluim e cila është në përputhshmëri me sugjerimet e Asociacioni evropian për sigurim të kualitetit në arsimin e lartë (ENQA).



Vetëevaluimin e Universitetit dhe njësive akademike e realizon komisioni për vetevaluim I universitetit gjegjësisht komisionet e njësive akademike më së paku në tre vjet. Raporti I vetevaluimit të Universitetit respektivisht njësive akademike përpilohen bazuar në rregulloren dhe standardet që I sjellë Këshilli Nacional. Përfshirë ky raport dhe raportet e njësive akademike, në mungesë të rregullores nga këshilli naciona, janë përpiluar sipar Udhëzuesit për vetevaluim dhe sigurim të cilësisë të njësive akademike të UT, të sjellë nga senati I Unviersitetit.

Pjesë e vetevaluimit është edhe ankeimi i studentëve e cila përfshinë vlerësimin e kuadrit mësimdhënës dhe të bashkëpunëtorëve për çdo lëndë të cilën e dëgjojnë studentët.

#### 4.4. Aktivitetet kërkimore

Në të gjitha njësitë e Universitetit të Tetovës realizohen aktivitete kërkimore-shkencore dhe aplikative., kurse Universiteti e përkrah veprimtarinë e përhershme profesionale si atë hulumtuese edhe atë artistike të punonjësve dhe studentëve me interes të përgjithshëm dhe në mënyrë publike i prezanton dhe i shpall rezultatet e veprimtarisë së tillë. Për faktin se Universiteti është i orientuar të mbështesë veprimtarinë kërkimore-shkencore tregon edhe veprimtaria e Zyrës për Hulumtime shkencore dhe Inovacion (ZSHI) e cila stimulon dhe mbështet organizimin e konferencave shkencore nga njësitë akademike të universitetit (tabela), si dhe publikimin e revistës shkencore në çdo njësi akademike. Në kuadër të çdo njësie akademike, në mbështetje dhe stimulim të aktiviteteve kërkimore-shkencore janë edhe dekanët për shkencë. UT organizon konferenca dhe publikime të revistave shkencore. Në kuadër të njësive akademike formohen komisionet, (bordi organizativ i konferencës dhe bordi shkencor) të cilat miratohen nga Këshilli mësimor-shkencor. Në kadër të UT publikohen 11 revista shkencore (Shtojca 3) të cilat janë të indeksuara në Google scholar dhe Index Copernicus International. Gjithshtu, 5 revista janë të indeksuara në COOEL, 4 revista janë me indexim në ERIHPLUS, kurse shtatë prej tyre në Academic Search Complete (EBSCO). Për përkushtimin në rritje të aktiviteteve kërkimore shkencore gjatë tre viteve akademike tregues janë edhe rritja e numrit të organizimeve të konferencave ndërkombëtare nga njësitë akadmeike të Unviersitetit. Më konkretisht, gjatë vitit akademik 2016/17 shatë njësi akademike të UT kanë organizuar konferenca shkencore ndërkombëtare si dhe tetë organizime të konferencave ndërkombëtare gjatë vitit akademik 2017/18. Në vitin akdemik 2018/19 janë organizuar nëntë konferenca ndërkombëtare nga njësitë akadmike të Universitetit si dhe Kongresi ndërkombëtarë i shkencave humane, sociale dhe arteve (Shtojca4).



## UNIVERSITETI I TETOVËS УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Numri i publikimeve në revista shkencore nga stafi i universitetit është në rritje të dukshme për periudhën të cilën e përfshinë ky raport evaluimi. Mes tjerash kjo del si rezultat i kërkesave ligjore të parapara me Ligjin për Arsim të Lartë për publikim të punimeve shkencore me qëllim të avancimit të stafit. Momenti motivues është edhe stimulimi financiar nga Ministria e Arsimit për publikime të punimeve shkencore në revista ndërkombëtare me impakt faktor.

Në Universitet gjatë periudhës 2016-2019 janë realizuar një sërë projektsh nacionale por edhe ndërkombëtare. Stafi i Universitetit nga njësitë akademike mer pejsë në proekte dhe studime kërkimore-shkencore të cilat menaxhohen nga shërbimet e Universitetit.

### 4.5. Anketimi i studentëve

Në procesin e evaluimit kanë marrë pjesë gjithsej 277 student, nga të gjithë fakultetet, respektivisht programet studimore (Shtojca 5). Studentët kanë vlerësuar nivelin e kënaqësisë së informimit/punës së referentëve, kordinatorëve të ECTS, shefave të programeve studimore dhe të dekanëve në shkallë prej 1 “aspak të kënaqur” deri në shkallën 4 “plotësisht të kënaqur”. Në nivel universitar, studentët deklarojnë se janë kënaqur me punën e referentëve (M=2, 94) si dhe kordinatorëve të ECTS (M=2.96) në kuadër të njësive akademike përkatëse. Më tej, studentët kanë vlerësuar se janë shumë të kënaqur me punën e shefave të programeve studimore në të cilët ata studiojnë (M=3.06), si dhe me munën e dekanëve të cilët menaxhojnë fakultete në të cilët ata janë student (M=2.97). Si pjesë e anketimit të studentëve është përfshirë edhe vlerësimi i procesit mësimor për çdo lëndë, respektivisht realizimi i ligjëratave dhe ushtrimeve nëpërmjet disa komponentëve: a. vlerësimin e mësimdhënësve në ligjërata dhe veçmas në ushtrime nëpërmjet indikatorëve si vijon: mbarëvajtjes, rregullshmërisë së mbatjes së orëve, shfrytëzimit konstruktiv të orëve, Përgaditjen dhe përcjelljen e informatave gjatë mësimdhënies; Stimulim të studentëve për zbatim të informatave në praktikë. Studentët gjithashtu kanë raportuar edhe për rregullshmërinë e tyre në ligjërata dhe ushtrime. Për të gjitha indikatorët e lartëpërmendur vlerësimi ka qenë në shkallë prej 1 “aspak” deri në 4 “plotësisht”.

Studentët kanë vlerësuar se mënyra e testimit të tyre qoftë nëpërmjet kolokviumeve ose të testeve përfundimtare realizohet në përputhshmëri me materjalin e ofruar nga mësimdhënësit për përgaditje të lëndës (M=3.44). Rregullshmëria e procesit të mbarëvajtjes së orëve në ligjërata dhe në ushtrime është vlerësuar nga studentët se është në përputhshmëri me planifikimin e realizimit të lëndës/ve. Konkretisht studentët vlerësojnë se mësimi fillon shumë sakt sipas orarit të planifikuar si në ligjërata



## UNIVERSITETI I TETOVËS

УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

(M=3.37) dhe në ushtrime (M=3.39). Marrë në tërësi të gjitha lëndët, studentët vlerësojnë se mësimdhënësit kanë qenë shumë të qartë në ligjërata (M=3.40) dhe në ushtrime (M=3.41). Gjeneralisht studentët vlerësojnë se profesorët kanë bërë lidhshmërinë e përmbytjes me përdorimin praktik të njohurive në ligjërata (M=3.19) por edhe në ushtrime (M=3.23). Rregullshmërinë e tyre në ligjërata, mare në tërësi e vlerësojnë se ka qenë në nivel të lartë sin ë ligjërata (M=3.60) ashtu edhe në ushtrime (M=3.56). Vlerësimet e studentëve varojnë sipas fakulteteve të ndryshme, megjithatë, deklarojnë nivel të lartë të kënaqësisë nga informimi i personave përkatës në kuadër të nësisve akademike, por edhe nga procesi i realizimit të mësimdhënies.

Anketimi i studentëve ka qenë vullnet i lirë i studentëve në plotësimin e pyetësorit për evaluim. Megjithat, duke mare parasyshë intenyitetin e ulët të angazhimit të pjesëmarësve në plotësim të pyetësorit për evaluim, sugjerohet që në të ardhmen të krijohen mekanizma shtesë të cilat do të siguronin plotësim të të njëjtit nga numër i konsiderueshëm i studentëve.

### 5. Evaluim i aktiviteteve të Universitetit

Universiteti i Tetovës në vazhdimësi kujdeset për sigurim dhe avansim të kualitet të të gjitha sferave të saja vepruese nëpërmjet mekanizmave për sigurim të cilësisë. Përveç vetevaluimit, evaluimi i jashtëm nga ekspert të Asociacionit të Universiteteve Evropiane (AUE) është mekanizmi tjetër të cilin e aplikon Universiteti për sigurm cilësie.

Në Universitet realizohet sigurimi dhe kontrolla e kualitetit nëpërmjet procesit të vetevaluimit të gjithë veprimtarive të cilat i realizon si: vlerësim i njësive akademike, programeve studimore përfshirë edhe lëndët, veprimtarisë akademike dhe kërkimore-shkencore, menaxhimit, metodave e mënyrave të punës, mësimdhënies e mësimnxënies. I njëjti realizohet nga komisionet e njësive akademike, kurse vetevaluimi i Universitetit realizohet nga Komisioni Qendror. Raportet për evaluim të njësive akademike realizohen duke u bazuar në udhëzuesin për evaluim të njësive akademike, të sjellë nga Senati. Vetevaluimi i njësive akademike dhe i Universitetit ka për qëllim të paraqesë programet studimore të njësisë, fakultetet e Universitetit, procesin mësimor dhe kërkimor-shkencor. Pjesë e pandashme e raportit është edhe anketimi i studentëve në lidhje me procesin e mësimor dhe shërbimet tjera studentore të cilat i ofron Universiteti. Konkretisht, studentët vlerësojnë mësimdhënien për çdo lëndë, për ligjërata dhe ushtrime, mënyrën e vlerësimit të tyre por edhe informimin nga sektorë të ndryshëm, si referent, koordinator e të ngjshëm. Në raport, gjithashtu



**UNIVERSITETI I TETOVËS**  
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

paraqiten edhe anët e fuqishme, mënyrat për të ndikuar në ndërmarrjen e hapave për ndryshime të dukurive jo të fuqishme, si dhe raporti paraqet bazë për vetevaluim të Universitetit dhe për evaluimin e jashtëm, të cilin e realizon Këshilli për Akreditim dhe Evaluim. Raporti i vetevaluimit të njësive akademike miratohen nga këshilli mësimesh shkencor i fakultetit kurse raporti i Komisionit qendror për evaluim miratohet nga Senati i Universitetit.

Cilësia e programeve studimore është një nga prioritetet e Universitetit, kurse vetevaluimi gjatë viteve akademike 2016/2019 ishte i fokusuar në këtë drejtim duke u bazuar në kriteret disa prej të cilëve janë: vlerësimi i lëndëve të programit studimor në raport me klasifikimin e Fraskatit, funksioni i lëndëve në përfitim të kompetencave të studentëve, ngarkesa me numër kredishë dhe kërkesat për angazhim në lëndët përkatëse por edhe lidhshmëria e tyre me kërkesën e tregut të punës. Në nivel të përgjithshëm analiza e programeve studimore tregon se është e nevojshme ridefinim i kompetencave të lëndëve të caktuara me qëllim që të jenë në përputhshmëri me deskriptorët e programeve studimore. Gjithsesi se vlerësimi tregoi edhe nevojën për azhurnim të literaturës që përdoret për lëndë të caktuara me qëllim të ndjekjes së trendit të zhvillimeve bashkëkohor shkencore (analiza për çdo njësi akademike gjendet në publikimin “Kycja e palëve të interesit në zhvillimin e kurikulave të programeve studimore: nevojë për përmirësimin e kualitetit në arsimin e lartë”)

Me qëllim të arritjes vlerësimi të kompetencës së plotësimi të nevojave të tregut të punës, Zyra për menaxhim me cilësi dhe evaluim gjatë vitit 2019 realizoi gjurmim të tregut në rajonin e maqedonisë veriperëndimore me qëllim të eksplorojë nevojat e tregut të punës në lidhje me kompetencat e nevojshme për punëtorë të ardhshëm në profilet përkatëse të kompanive/institucioneve. Të dhënat nga të intervistuarit dhe pjesëmarrësit e përfshirë në hulumtim janë mbledhë me qëllim që të krijohet pasqyrë për: (a) Njohuritë e nevojshme që duhet ti kenë të përfituara punonjësit për të kryer aktivitete në sektorin/ pozitën e punës përkatëse. (b) Shkathtësi/ aftësitë për të zbatuar njohuritë e fituara; (c) Shkathtësi të nevojshme komunikimi për interaksione me palët/bashkëpunorët relevant si dhe aftësi për vlerësim dhe të mësuarit të mëtutjeshëm.

Këto të dhëna u prezantuan para shefave të programeve studimore si dhe rekomandimet iu dorëzuan me qëllim që të njëjtat të meren parasysh/adaptohen gjatë riakreditimit të programeve studimore. Të dhëna të detajuara dhe rekomandime për profile të ndryshme janë të publikuara ne doracakun Kycja e palëve të interesit në zhvillimin e kurikulave të programeve studimore: nevojë për përmirësimin e kualitetit në arsimin e lartë.



## 6. SWOT analiza

Strategjia e universitetit bazohet në SWOT analizë e cila i mer për bazë anët e fuqishme, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet e mundëshme dhe në bazë të saj mbështet zhvillimin e unviersitetit.

### Anët e fuqishme:

- Universitet publik i parë dhe më i vjetër në vend që ofron mësimdhënie në gjuhën shqipe.
- Ofrim injë palete të gjerë të programeve studimore duke u nisur nga ato matematike natyrore, sociale dhe humane duke vazhduar me shkencat mjekësore dhe ato aplikative;
- Infrastrukturë e përshtatshme në pjesën dërmuese të njësive akademike dhe klimë pozitive dhe kooperuese;
- Gjeneralisht dominon moshë e re e e stafit akademik;
- Stimulim i studentëve nëpërmjet ofrimit të mundëive për lirim nga participimi
- Staf akaedmik që posedon njohuri përvojë dhe aftësi të përcjellë njohuri dhe shkathtësi të drejtuara nga student në qendër të vëmendjes por edhe kultivimin e një mjedisi të hapur ku mundësohet të menduarit kritik dhe kreativ
- Rritje e aktiviteteve kërkimore shkencore si organizim konferencash dhe revistave shkencore

### Dobësi

- Numër i vogël i bashkëpunëtorëve të rregullt
- Krijim i rrjetit Alumni për ndjekjen e zhvillimit profesional të studentëve të diplomuar
- Interesim jo i mjaftueshëm nga ana sektorit privat dhe institucioneve shtetërore për shfrytëzimin e potencialit intelektual;
- Nevojë e avansimit të infrastrukturës laboratorike në disa njësi akademike
- Nevojë për trajnime të vazhdueshme të kuadrit akademik për aplikime në projekte ndërkombëtare
- Nevojë për trajnime të vazhdueshme të kuadrit akademik për aplikime të metodave bashkëkohore të mësimdhënies



## Mundësitë

- Programe studimore të adaptuara në bazë të kërkesave për kompetenca të studentëve nga tregu i punës
- Pjesëmarrja e studentëve dhe mësimeve në programe të mobilitetit
- Bashkëpunimi me bizneset dhe grupe të tjera të interesit;
- Bashkëpunim me universitete tjera të vendit dhe rajonit
- Krizë e gjatë ekonomike që sjellë në rrënie të kërkesës së fuqisë punëtore për profile të caktuara të njësive akademike
- Ruajtja e studentëve ekselent si pjesë e stafit të Universitetit

## Rreziqet

- Ndryshimet demografike dhe migrimi si faktor që kontribuojnë në uljen e dukshme të numrit të studentëve
- Rritja e numrit institucioneve të shumta të arsimit të lartë në RMV

## 7. Përfundim

Sipas SWOT analizës mund të përfundohet se Universiteti i Tetovës si Universitet i parë publik më mësim në gjuhën shqipe dhe me një gamë të gjerë të programeve studimore si dhe me kuadër të përgaditur profesionalisht duhet të fokusohet në të ardhmen në:

-vazhdimin e përputhshmërisë së programeve studimore me programe studimore evropiane dhe të vazhdojë edhe më tutje të jetë në përgaditje të studentëve të cilët do të jenë të aftë të adresojnë kërkesat e tregut të punës.

-Universiteti duhet të vazhdojë të mbështesë punën kërkimore shkencore nëpërmjet organizimit të konferencave nacionale dhe ndërkombëtare si dhe të vazhdojë të jetë i qëndrueshëm publikimi i revistave shkencore

-orientimi i Universitetit duhet të jetë i fokusuar në vazhdimin e rritjes së bashkëpunimeve me universitetet tjera evropiane por dhe botërore dhe rritjen e projekteve bilaterale dhe ndërkombëtare

-Universiteti i Tetovës duhet të vazhdojë me mbështetjen e studentëve nëpërmjet formave të ndryshme, si mbështetje të ekselentëve por edhe të aktiviteteve studentore kulturore e artistike.





-Bashkëpunimi me biznes sektorin por edhe aktivizimi i laboratorëve dhe parqeve teknologjike do të kontribuojë për zhvillimin e bashkësisë por edhe të etablimin e Universitetit në vend por edhe më gjerë.

## 8. Shtojca

- Shtojca 1. Struktura e studentëve për periudhën 2016-2019
- Shtojca 2. Kuadri akademik
- Shtojca 3. Listë e revistave të publikuara
- Shtojca 4. Konferencat
- Shtojca 5. Anketimi i studentëve